Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0027666/24
Data 13 06 -2024

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Në bazë të nenit 11, nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e programeve të veçanta të banimit, dhe neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 13.05.2024, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 07.06.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

(Për miratimin e Programit komunal trevjeçar për banim për Komunën e Skenderajt 2024-2026)

**Neni 1**

Miratohet propozimi-vendim më Nr.08-060/01-0023492/24, i datës 20.05.2024, Për miratimin e Programit komunal trevjeçar për banim për Komunën e Skenderajt 2024-2026.

**Neni 2**

Programit komunal trevjeçar për banim në Komunën e Skenderajt 2024-2026, ka për qëllim identifikimin e rasteve dhe ndihmën për sigurimin e banimit për kategori të ndryshme të qytetarëve të komunës së Skenderajt, po ashtu është edhe krijimi i kushteve për banim të përhershme dhe të qëndrueshme me harmoni me normat dhe standardët evropiane të banimit.

**Neni 3**

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Drejtoria për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb - faqen e Komunës.

**Bashkëngjitur:** Programit komunal trevjeçar për banim për Komunën e Skenderajt 2024-2026.

**Vendimi i Dërgohet :**
1x1 Arkivit,
1x1 Zyrës së Kryetarit .
1x1 DSHMS-së,
1x1 MAPL-së,
1x1 Dosjes.

**KRYESUESJA E KUVENDIT**
znj. Adelina Spahiu

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr./No. 01-060/01-0027666/24
Data/Datum 13.06.2024

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Na osnovu člana 11, člana 12 stav 1 i 2 tačka d), Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, prema članu 20 Zakona br. 03/L-164 o finansiranju posebnih stambenih programa, i član 14 st. 1 i 2 slova d) Statuta opštine Srbica br. 01-110-385, od 13.05.2024.godine, Skupština opštine Srbica je na redovnoj sednici održanoj 07.06.2024.godine usvojila sledeće:

# ODLUKU

(Za usvajanje trogodišnjeg opštinskog Programa stanovanja za opštinu Srbica 2024-2026.)

**Član 1**

Usvaja se Predlog odluke br. 08-060/01-0023492/24 od 20.05.2024. godine za usvajanje trogodišnjeg opštinskog Programa stanovanja za opštinu Srbica 2024-2026.

**Član 2**

Trogodišnji opštinski program za stanovanje u opštini Srbica 2024-2026, ima za cilj da identifikuje slučajeve i pomogne u obezbeđivanju smeštaja za različite kategorije građana opštine Srbica, kao i stvaranje uslova za trajno i stabilno stanovanje u skladu. sa evropskim stambenim normama i standardima.

**Član 3**

Sprovodjenje ove odluke je dužna da vrši: Direkcija za zdravstvo i socijalno bladostanje pod nadzorom predsednika opštine Skenderaj.

**Član 4**

Ova odluka stupa na snagu 15 dana od dana registracije u protokolarnoj kancelariji MALS-a, kao i objavljivanja na internet stranici - sajtu opštine.

**U prilogu:** Trogodišnji opštinski stambeni program za opštinu Srbica 2024-2026.

**Odluka se dostavlja :**
1x1 Arhivi;
1x1 Kabinetu predsednika;
1x1 DZSB-a;
1x1 MALS-a;
1x1 Dosiji.

**PRESEDAVAJUĆA SKUPŠTINE:**
gđa Adelina Spahiu

DL 3901-3/24
02 05.07.24
PRISHTINË / A

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderaj<br>Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderaj | |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Minister i MAPL<br>Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Liburn Aliu, Ministër i MMPHI<br>Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI | |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor | Nr.VL 127/24 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Shendrita Latifi – zyrtare ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | Date: 20.06.2024 |
| Lënda: | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal | |
| Lloji i aktit: | Vendimi Nr. -1-060/01-0027666/24 për miratimin e planit komunal tre (3) vjeçar të banimit në komunën e Skenderajt, miratuar nga Kuvendi Komunal i Skenderajt, datë 07.06.2024 | |

I nderuar kryetar Nura,
E nderuar kryesuese Spahiu,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 18.06.2024 ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr. -1-060/01-0027666/24 për miratimin e planit komunal tre (3) vjeçar të banimit në komunën e Skenderajt, miratuar nga Kuvendi Komunal i Skenderajt, datë 07.06.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

KONFIRMON

Vendimin Nr. -1-060/01-0027666/24 për miratimin e planit komunal tre (3) vjeçar të banimit në komunën e Skenderajt, miratuar nga Kuvendi Komunal i Skenderajt, datë 07.06.2024.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Pas shqyrtimit të këtij Vendimi dhe Programin trevjeçar 2024-2026 për banim bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim duke u bazuar në nenin 2 - Përgjegjësitë e Komunave, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 konstatojmë se i njëjti është i harmonizuar me legjislacionin ne fuqi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Skenderajt dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.